USHTRIA

Viti i 72-të i botimit Nr. 6 (827603) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 8 Shkurt 2019

KOLONEL EDUART BALA TAKON MINISTRIN BOSHKOVIÇ



Bashkëpunimi me Malin e Zi në nivel biletaral dhe multibilateral

Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviq ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala.Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviq ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala. Boshkoviq dhe Bala kanë shkëmbyer mendime mbi bashkëpunimin e deritashëm në mes të Malit të Zi dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes. Zyrtarët ranë dakord se të dy vendet tona kanë bashkëpunim intensiv dhe efikas në fushën e mbrojtjes në nivel bilateral, i cili është vazhdimisht duke u përmirësuar me anë të shkëmbimit të përvojave…

» faqe 4

Xhaçka: Puna dhe përkushtimi shpërblehen

Gjeneral brigade Albert Mullai emërohet komandant i Forcës Tokësore

Ai do të zëvendësojë gjeneralmajor Nazmi Cahanin, i cili do të jetë përfaqësues ushtarak në selinë e NATO-s në Bruksel

» faqe 3



MINISTRJA XHAÇKA:

Urime Maqedonisë për këtë arritje të merituar



» faqe 3

Ekipi i ekspertëve të OKB-së

Testohen kapacitetet e deklaruara të FARSH

Një ekip i OKB ka zhvilluar një vizitë vlerësuese në Forcat e Armatosura të RSH, për kapacitetet e FARSH të cilat janë të deklaruara në sistemin e OKB për ti angazhuar dhe përdorur nëse do të kërkohet në misione nën drejtimin e OKB. Me anë të një prezantimi në Shtabin e Përgjithshëm, ekipi vlerësues i përbërë nga personel nga OKB dhe Komanda Evropiane e Forcave Amerikane...



» faqe 7

NATO dokumentar për Kuçovën

Gjenerali Tod Wolters: "Shqipëria vend me rëndësi kritike"

Baza e Kuçovës jo vetëm do të rikthejë lavdinë e dikurshme të atij aeroporti, por do jetë edhe baza e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor.Kanali televiziv i NATO-s i ka kushtuar një kronikë kësaj baze ajrore, një projekt ky sa ambicioz, aq edhe i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por mbi të gjitha për sigurinë rajonale.Kryeministri Edi Rama, ditën e martë, uroi mirëmëngjes...

» faqe 7



STOLTENBERG: KY ËSHTË NJË MOMENT HISTORIK

Maqedonia, anëtari më i ri i Aleancës

» faqe 8

27 VITE POLICI USHTARAKE

Policia ushtarake garanton sigurimin e bazës së NATO-s në Kuçovë

faqe 2

ZHVILLOHET "ORA E KOMANDANTIT" NË KDS

Gjeneral® Hoxha: Metodologjia e RSM bazohet në modelin e aleatëve

faqe 5

FIRMOSET NGA 29 AMBASADORË PROTOKOLLI I ANTARËSIMIT

Visho Ajazi firmos në emër të Shqipërisë, Maqedonia në NATO

Ambasadorët e 29 vendeve anëtare të NATO kanë nënshkruar të mërkurën më 6 shkurt 2019, në selinë e NATO-s në Bruksel, Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.

Firmosja e Protokollit për Antarësimin e Maqedonisë në NATO është bërë në prani të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, z.Jens Stoltenberg dhe Ministrit të Jashtëm të Maqedonise së Veriut, z. NIkolla Dimitrov. Secili shtet anëtarë i NATO-së veç e veç nënshkruan Protokollin, ndërsa shteti i parë që nënshkroi ishte Republika e Shqipërisë.

Në emër të qeverisë të Republikës së Shqipërisë, Protokolli i Antarësimit të Maqedonisë në NATO është firmosur nga z.Visho Ajazi, ambasador i Shqipërisë në NATO.

Protokolli që u firmos dje në Bruksel, duhet të ratifikohet nga Parlamentet përkatëse të 29 vendeve antare të NATO-s.

Me këtë rast sekretari gjeneral i NATO-së Jens Stoltenberg deklaroi se ky është një moment historik për vendin dhe se kryeministrat Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras kanë treguar guxim të madh me arritjen e Marrëveshjes së Prespës, me çka kanë dhënë kontribut të madh të stabilitetin dhe sigurinë e rajonit.Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Atlantike të Veriut, Jens Stoltenberg ka kërkuar para pak ditësh nga 29 vendet anëtarë të nënshkruajnë protokollin e anëtarësimit.Stoltenberg, tha se pasi 29 vendet të ratifikojnë protokollin, do të mund t'i urojnë Maqedonisë së Veriut mirëseardhje si anëtarja e 30-të.



Forca Tokësore

Nënkolonel Karakushi, Komandanti i ri i Forcave Speciale

Paraditen e dates 31 janar u zhvillua në mjediset e Komandës së Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore, ceremonia e ndërrimit të komandantit të këtij reparti elitë të FT. Ceremoninë, e nderoi me pjesëmarrjen e tij komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Nazmi Cahani si dhe shtabi i kësaj njësie.

Në fjalën e tij përshëndetëse komandanti në largim i batalionit të Forcave Speciale kolonel Ilirjan Dauti, shprehu mirënjohjen e tij për çdo ditë të punës së kaluar me efektivat specialë. "…ka qenë nder dhe privilegj, që për një periudhë 19 mujore të jem pjesë e Batalionit të Forcave Speciale. Gjatë kësaj periudhe, kemi punuar të gjithë së bashku për çuarjen më lart të emrit të repartit. Ndihem krenar, që bashkë me ju arritëm të përmbushim me sukses çdo detyrë të ngarkuar nga eprorët tanë. I uroj komandantit të ri suksese dhe ta çojë akoma më përpara emrin dhe prestigjin e bFS"-u shpreh ndër të tjera kolonel Dauti.

Më pas, fjalën e mori komandanti i ri i bFS nënkolonel Ramadan Karakushi, i cili fillimisht falënderoi kolonel Dautin për punën e bërë në drejtim të rritjes profesionale të batalionit, gjatë gjithë periudhës që ai shërbeu si komandant. Më tej, ai shprehu falenderimet e tij të veçanta për ministren e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, për besimin e treguar me emërimin e tij, në një detyrë kaq të rëndësishme. "…kolegë të nderuar, së bashku do të vazhdojmë rrugëtimin drejt konsolidimit të mëtejshëm të këtij batalioni. Sfida të mëdha na presin në përmbushjen e angazhimeve të marra në NATO, si pjesë e komunitetit të Forcave Speciale. Konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve operacionale, rekrutimi dhe përzgjedhja e personelit, vetëzhvillimi dhe mbështeja e burimeve njerëzore, do jetë synimi i përbashkët për të ardhmen."- tha ndër të tjera nënkolonel Karakushi.

Gjeneralmajor Cahani, e nisi fjalën e tij përshëndetëse me falenderimet dhe mirënjohjen e tij personale për punën



përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar nga kolonel Dauti ish-komandant i batalionit të Forcave Speciale, për aq kohë sa ai drejtoi këtë batalion. "…ka qenë kënaqësi e madhe për mua, të punoja me ushtarakë si kolonel Dauti, i cili ka punuar me disipinë të lartë për rritjen profesionale të trupës së Forcave Speciale. Jam i bindur, që edhe në detyrën e re që ai ka marrë, do jetë i aftë të tregojë vlerat e tij më të mira, si ushtarak karriere." - tha gjeneralmajor Cahani.

Ai shprehu gjithashtu besimin e tij të plotë, se edhe komandanti i ri i Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ramadan Karakushi, do të jetë i aftë që punën e mirë të bërë nga kolonel Dauti do ta çojë në një stad edhe më të lartë, duke bërë që efektivët e këtij reparti të vazhdojnë ta meritojnë emrin e lavdishëm të efektivave elitë të Forcave të Armatosura.Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

***

Komandanti i ri i Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore nënkolonel Ramadan Karakushi, është lindur në vitin 1976, në Kukës.Karriera e tij ushtarake si oficer karriere fillon në vitin me diplomimin në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1998 ne specialitetin "Tanke". Detyra e tij e parë, do të ishte ajo e komandantit të togës. Në vitin 1999 nënkolonel Karakushi përfundon me sukses kursin e Forcave Speciale nën drejtimin e instruktorëve turq, duke u barë kështu pjesë e batalionit të Forcave Speciale. Në këtë batalion ai do të zhvillonte më tepër karrierën e tij ushtarake në detyra të ndryshme si komandant grupi special, shef shtabi dhe për të arritur tek detyra më e lartë ajo e komandantit të Batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore.

Nënkolonel Karakushi regjistron në CV e tij një numër të konsiderueshëm kursesh trajnimi kryesisht në fushën e Forcave Speciale ku mund të përmendim: kursi i Forcave Speciale; kursi i luftimit të afërt; kursi për ruajten e personaliteteve; kursi i instruktorit; kursi për programin ekzekutiv OCC; kursi bazë për operacionet e mbështetjes se paqes; kursi për operacionet speciale kundër terrorizmit; etj.Nënkolonel Karakushi ka qenë pjesë e një sërë misionesh paqeruajtëse në zonat më të nxehta të globit si: Afganistan në vitet 2004,2011;2013, Irak 2005 dhe 2008 . Ai është dekoruar disa herë me medalje të ndryshme për shërbimet e tij ndaj atdheut.Komandanti i batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore nënkolonel Ramadan Karakushi është i martuar dhe ka një fëmijë.

27 vite Policia Ushtarake

Policia ushtarake garanton sigurimin e bazës së NATO-s në Kuçovë

Policia Ushtarake ka festuar më 1 shkurt 2019, 27-Vjetorin e krijimit të saj. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në mjediset e kësaj njësie, ishte i pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, si dhe drejtues të PU.

Në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi e vuri theksin tek përparimi dhe transformimi i bërë në Policinë Ushtarake në këto vite. Po ashtu, Koçi shtoi se roli i PU do të jetë thelbësor edhe në sigurimin e bazës së NATO, që do të ndërtohet në Kuçovë.

"Vendimi i Aleancës për të ngritur Bazën Ajrore në Kuçovë është një votëbesim i ri i partnerëve tanë, jo vetëm për rolin politik edhe ushtarak të Republikës së Shqipërisë në rajonin tonë, por edhe një vlerësim për përparimin e reformave në zhvillimin bashkëkohor të Forcave tona të Armatosura, për këtë kanë meritë të gjitha strukturat tona të FA, përfshirë edhe Policinë Ushtarake, e cila natyrisht do të ketë një rëndësi të veçantë në sigurimin e kësaj baze.", - tha ai.

I pranishëm në këtë aktivitet, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, tha se Policia Ushtarake ka treguar konsolidim dhe dinamizëm në kryerjen e të gjithë detyrave të ngarkuara në këto 27 vite.

"Për më shumë se çerek shekulli rrugëtim, në vlerësojmë Policinë Ushtarake si një histori suksesi në përballje më vështirësi, sfida në aktivitete dhe kontribut të prekshëm në mbështetje të gjithë rrugëtimit dhe suksesit të aktivitetit të FA-ve branda dhe jashtë vendit", - përfundoi Kollçaku Policia Ushtarake u krijua me 1 shkurt të vitit 1992 si një strukturë e domosdoshme për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në Forcat e Armatosura.

Policia Ushtarake (PU) ka në misionin e saj ruajtjen e rendit ushtarak në FARSH, garantimin e zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në FA, mbrojtjen e jetës së personelit, mbrojtjen e pronës shtetërore në administrim dhe



përdorim të MM dhe FA, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare. Struktura e PU bën të mundur plotësimin e detyrave dhe objektivave që dalin nga ky mision. Gjatë këtyre viteve të fundit PU, është trajnuar nga specialist të huaj si ata të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke. Gjithashtu ajo po përgatitet edhe si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO, e aftë dhe e pajisur përshtatshmërish për të përmbushur detyrat.

Policia Ushtarake është një nga strukturat më elitare të Forcave tona të Armatosura që merr pjesë jo vetëm në operacione brenda vendit por edhe në menaxhimin e krizave botërore përkrah aleatëve. Vitet e fundit pajisja dhe modernizimi i Policisë Ushtarake ka përmirësuar dukshëm kapacitetet duke e pajisur këtë njësi me armatim, mjete dhe teknologji bashkëkohore.Ajo ka mision sigurimin dhe ruajtjen e pjesëtarëve dhe pasurive ushtarake, mbajtjen e rregullit dhe disiplinës dhe zbulimin e veprave penale ushtarake. Veprimtaria e Policisë Ushtarake ushtrohet mbi të gjitha subjektet ushtarake e civile, vendase dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilët, me veprimet e tyre, cenojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në përmbushje të ushtrimit të juridiksionit territorial janë organizuar dhe funksionojnë Seksionet e Policisë Ushtarake në rrethe me përhapje, në Kukës, Shkodër, Elbasan, Durrës, Berat, Vlorë, Burrel, Gjirokastër dhe Korçë.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Gazetarë:
Saimir ALIJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ
Redaktore/Korrektore:
Anila DODA

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Xhaçka: Puna dhe përkushtimi shpërblehen

Gjeneral brigade Albert Mullai emërohet komandant i Forcës Tokësore

Ai do të zëvendësojë gjeneralmajor Nazmi Cahanin, i cili do të jetë përfaqësues ushtarak në selinë e NATO-s në Bruksel

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka deklaroi se vlerësimi i profesionistëve dhe njerëzve të përkushtuar është motoja e punës në Forcat e Armatosura. Ministrja mori pjesë më 2 shkurt 2019, në ceremoninë e ndërrimit të komandantëve të Forcës Tokësore. Gjeneral brigade Albert Mullai mori detyrën e komandantit të Forcës Tokësore duke zëvendësuar gjeneralmajor Nazmi Cahanin, i cili e mbajti këtë post për më shumë se tre vjet. "Puna e palodhur, përkushtimi, profesionalizmi gjithmonë do të shpërblehen. Kjo është motoja e punës sonë, është motoja e punës sime është objektivi i punës sime është objektivi që ne i kemi vënë vetes dhe është standardi i panegociueshëm që ne do të zbatojmë në të gjitha strukturat e FA. Por puna dhe zhvillimi më tej i FT nuk ka përfunduar dhe kemi shumë sfida të tjera përpara. Dua t'i shpreh dhe dua ta siguroj gjeneral Mullain se në Ministrinë së Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm do të keni gjithë mbështetjen e duhur për të realizuar qëllimin tonë të përbashkët, përmbushjen e misionit që i është ngarkuar Forcës Tokësore dhe Forcave të Armatosura në përgjithësi." - tha ministrja Xhaçka në fjalën e saj. Gjeneralmajor Nazmi Cahani dorëzoi detyrën duke falënderuar gjitha bashkëpunëtorët e tij gjatë tre viteve në krye të Forcës Tokësore, ndërkohë që komandanti i ri i kësaj force gjeneral brigade Albert Mullai falënderoi ministren Xhaçka për besimin dhe e siguroi se fokusi i punës së tij do të jenë stërvitja dhe kujdesi për kushtet e punës, për gjithë efektivët e



Forcës Tokësore dhe familjet e tyre. Gjeneralmajor Nazmi Cahani do të vijojë të shërbejë në Forcat tona të Armatosura, si përfaqësuesi ushtarak në selinë qendrore të NATO në Bruksel. Pak më muaj më parë, nën monitorimin e NATO u certifikua Grup-Batalioni i Lehtë i Këmbësorisë, pjesë e Forcës Tokësore, ndërkohë që në qindra stërvitje kombëtare e ndërkombëtare efektivët e kësaj force nuk kanë qenë numra në formacione, por kanë sjellë në vendin e tyre trofe e vlerësimet më të mira nga vendet anëtare të NATO.



Ministrja Xhaçka:

Urime Maqedonisë për këtë arritje të merituar



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka e ka cilësuar lajm të shkëlqyer firmosjen e Protokollit për anëtarësimin e Maqedonisënë NATO, në selinë e NATO-s në Bruksel, nga 29 vendet antare të Aleancës. "Lajm i shkëlqyer sot. Urime qytetarëve të Maqedonisë së Veriut për këtë arritje të merituar. Aleanca hapi krahët dhe dyert për të mirëpritur anëtarin e vet të 30-të në familjen më të madhe politiko-ushtarake. Një mesazh i fortë strategjik për fqinjët tanë dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Prej ditës së sotme rajoni ka fituar më shumë siguri, stabilitet dhe paqe", shkruan Xhaçka në facebook.

Gjeneral brigade Albert Mullai, studimi dhe karriera ushtarake



Arsimimi dhe klualifikimi

Gjeneral brigade Albert Mullai ka lindur më 23 shkurt 1964 në Tiranë.Në vitin 1988 ka mbaruar Akademinë Ushtarake "Skënderbej" dhe nga vitit 1995 deri 1998 ka vazhduar me kurse trajnimi në Mitenwald-Gjermani, Spiezh-Zvicër dhe Varna-Bullgari. Në vitin 1999 ka kryer kursin e Politikave të Sigurimit Europian në "Marshall Center" Garmisch, Paternkirschen, Gjermani; në vitin 2001 Kursin e Politikave të Sigurimit Europian (GCSP) në Qendrën e Politikave të Sigurimit të Gjenevës, Zvicër; në vitin 2002 Kursin e Terminologjisë së NATO, i zhvilluar në AFNORTH, NATO, Brunssum; në vitin 2003 Kursin e Familiarizimit me NATO, Bruksel, Belgjikë; në vitet 2003-2005 ka kryer Kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë; në vitin 2005 Akademinë Diplomatike Shqiptare, Tiranë dhe në vitin 2006 ka kryer Kursine Politikave të Sigurimit të SHBA, pas 11 Shtatorit, i oganizuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA, Universiteti i Kalifornisë, San Diego. Ai zotëron tre gjuhë të huaja: Anglisht, Italisht dhe Rusisht.

Pjesëmarrja në misione të NATO:

Gjeneral brigade Albert Mullai ka marrë pjesë në disa misione të NATO-s. Në vitin 2015-2016 ka qënë Këshilltar i Lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA afgane në kuadër të "Resolute Support Mission" të NATO. Në vitin 2013-2016 Atashe i Mbrojtjes i RSH në SHBA, Washington DC, SHBA. Në vitin 2009-2011 Oficer Shtabi për Operacionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH në NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë.Në vitin 2007-2009Oficer Shtabi për Personelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS të NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë. Në vitin 2006-2007 Përfaqësues ne Komitetin Drejtues te Ministerialit të Mbrojtjes të vendeve të Europës Juglindore, SEDM-PMSC. Kurse nga viti 2006 e këtej ka qënë disa here pjesëmarrës në stërvitje shumëkombëshe në Gjermani, Slloveni, Kroaci, FYROM, Bullgari , Rumani, Greqi e Ukrainë.

Karriera ushtarake dhe eksperiencë pune

Me të mbaruar Akademinë Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1988 titullohet oficer dhe emërim Komandant Toge Këmbësorie në BrK, Laç; më pas titullohet Komandant Kompanie në Brigadën e Këmbësorisë, Laç dhe po në Laç titullohet Instruktor Stërvitje në S-3 të Brigadës së Këmbësorisë, Laç. Ai kthehet në Tiranë dhe nga vitet 1991-1996 ka punuar Pedagog Zjarri në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", Tiranë. Në vitin 1997 Zëvendësshef i Seksionit G-3 të Bazës së Furnizimit të FA, Tiranë dhe në vitet 1997-1999 punon si Zëdhënës i Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitet 1999-2000 Specialist në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë të MM,2000-2002 Specialist në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë të MM,2002-2003 Shef i Sektorit të Modernizimit dhe Ndërveprimit të J5 në SHPFA,2003-2005 Kursi i Shtabit të Përgjithshem në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë,2005-2006 Shef i Sektorit të Marrëdhënieve dypalëshe në Drejtorinë e Politikave dhe Integrimit të MM, 2006-2007 Shef i Sektorit të Arsimimit të J-1 në Shtabin e Pergjithshëm të FA, 2007-2009 Oficer Shtabi për Personelin (PSE Staff Element) në Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar IMS të NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë,2009-2011 Oficer Shtabi për Operacionet dhe Stërvitjen në Përfaqësinë e Përhershme Ushtarake të RSH në NATO, NATO HQ, Bruksel, Belgjikë,2011-2012 Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik të Politikave të Personelit,2012-2013 Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM,2013-2014 Atashe i Mbrojtjes i RSH në SHBA, Washington DC, SHBA,2014-2015 Shef i Planifikimit Afatgjatë të Komandës Mbështetëse,2015-2016 Këshilltar i Lartë për Personelin pranë Ministrisë së Mbrojtjes e Shtabit të Përgjithshëm të FA afgane në kuadër të "Resolute Support Mission" të NATO dhe në vitet 2017-2019 punon si Komandant i Akademisë së Nënoficerëve "Thomson", Tiranë.

Kolonel Eduart Bala takon ministrin Boshkoviç

Bashkëpunimi me Malin e Zi në nivel biletaral dhe multibilateral

Atasheu ushtarak jo resident i Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala takohet me ministrin e Mbrojtjes të Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviç



Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviq ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala.

Ministri i Mbrojtjes Malit të Zi, z.Predrag Boshkoviq ka pritur në një takim zyrtar atasheun ushtarak jo resident të Republikës së Shqipërisë në Malin të Zi, Kolonel Eduart Bala.

Boshkoviq dhe Bala kanë shkëmbyer mendime mbi bashkëpunimin e deritashëm në mes të Malit të Zi dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes. Zyrtarët ranë dakord se të dy vendet tona kanë bashkëpunim intensiv dhe efikas në fushën e mbrojtjes në nivel bilateral, i cili është vazhdimisht duke u përmirësuar me anë të shkëmbimit të përvojave dhe trajnimit të personelit, por edhe në nivel multilateral, i cili përmes angazhimit të përbashkët në projekte të formatit rajonal të të dy vendeve në mënyrë aktive kontribuojnë në dialog si një çelës për arritjen e paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor.

Ministri Boskoviç përgëzoi Kolonel Balën për dhjetë vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe uroi që të dy vendeve tona dhe në të ardhmen, si aleatë në kuadër të Aleancës, të bashkëpunojnë ngushtë dhe të kontribuojnë në ruajtjen e një rajoni të qëndrueshëm. Kolonel Bala shprehu shpresën se gjatë qëndrimit të tij, do të kontribuojë që bashkëpunimi ushtarak bilateral mes dy vendeve do të zhvillohet vazhdimisht si në projektet bilaterale dhe multilaterale, të cilat nuk kontribuojnë vetëm në efikasitetin e sistemit të mbrojtjes kombëtare, por edhe forcimin e kornizës rajonale të sigurisë.

Kolonel Eduart Bala ka zhvilluar takime të ndara edhe me shefin e Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, gjeneral brigade Dragutin Dakiç, Drejtorin e Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes, z Ivica Ivanoviq, si dhe shefin e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Andrej Lakić. Gjatë të gjitha takimeve u theksua përkushtimi për forcimin e bashkëpunimit bilateral me Republikën e Shqipërisë dhe Malit të Zi, në fushat me interes të përbashkët.

KM-BATALIONI I XHENIOS

Hapen 7,8 km rrugë të bllokuara në Picar të Gjirokastrës

Rikthimi i reshjeve të dëborës në zonat malore, ka sjellë probleme në rrugët e disa fshatrave. Gjatë gjithë këtyre ditëve Forcat e Armatosura në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave Civile kanë qenë në gatishmëri për t'u ardhur në ndihmë banorëve të zonave në vështirësi për shkak të rrugëve të bllokuara. Një tjetër operacion i përfunduar me sukses është ai i Batalioni të Xhenios të KM, i cili realizoi më 31 janar hapjen e rrugës së bllokuar nga dëbora në fshatin Golem të Njësisë Administrative Picar, në Prefekturën e Gjirokastër. Ky operacion mundësoi hapjen e 7,8 km rrugë. Kjo rrugë kryesore lidh këtë fshat me njësinë administrative. Po ashtu me hapjen e rrugës fëmijët e kësaj zonë mund të ndjekin rregullisht mësimin. FA vazhdojnë të jenë në gatishmëri për çdo rast emergjence në ndihmë të banorëve që mund të kenë probleme si pasojë e motit të keq.

VAU I DEJËS, SHKODËR

Modernizimi i aftësive luftarake një detyrë e përhershme

Gjeneral brigade Albert Mullai vizitë njohëse në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT)

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai zhvilloi ditën e mërkurë, më 6 shkurt, një vizitë njohëse në Batalionin I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT) me venddisklokim në Vaun e Dejës, Shkodër, ku nëpërmjet një prezantimi të përgatitur me këtë rast u njoh me misionin, detyrat dhe problematikat kryesore, me të cilat hasen efektivat e b1kFT gjatë punës së tyre të përditshme.



Gjeneral brigade Mullai, gjatë kësaj vizite njohëse u shpreh mes të tjerash se: "Angazhimi juaj në misione paqeruajtëse në Afganistan si dhe kontributi i b1kFT në operacionet e Emergjencave Civile, në luftën kundër përmbytjeve dhe zjarreve, ka bërë që ju të meritoni jo vetëm mirënjohjen e lidershipit ushtarak dhe atij civil të Ministrisë së Mbrojtjes, por edhe të popullsisë së zonës. Si komandant i Forcës Tokësore, ju siguroj se do keni gjithmonë mbështetjen time, të Shtabit të Forcës Tokësore, por pa dyshim edhe të Shtabit të Përgjithshëm, çdo ditë të punës tuaj në drejtim të realizimit të misionit të përbashkët. Kujdesi për krijimin e kushteve optimale të punës si dhe mbështetja për familjet tuaja, do të jetë gjithmonë në fokus të punës time. Duke qenë se ne jemi anëtarë të NATO, kjo na bën jo vetëm përfitues të sigurisë, por kërkon nga ne të jemi edhe kontribues te denjë. Modernizimi dhe rritja e aftësive luftarake të reparteve të Forcës Tokësore, duke përfshirë rritjen e nivelit të stërvitjes, në kushte sa më reale, ngritja e poligoneve taktike dhe atyre të qitjes, aftësitë fizike dhe gjuhët e huaja, duhet të mbeten për të gjithë ne një detyrë e përhershme ".

Më pas, i shoqëruar nga komandanti i b1kFT, nënkolonel Ali Mali, gjeneral brigade Mullai vizitoi mjediset e punës dhe të stërvitjes si dhe të jetesës së personelit të Batalionit I të Këmbësorisë së Forcës Tokësore.Vizita e komandantit të Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai në Batalionin I të Këmbësorisë vjen në kuadër të njohjes dhe prezantimit me personelin e reparteve vartës të Forcës Tokësore.

KOMANDA MBËSHTETËSE



Trajnim për procedurat e reja të teknologjisë së informacionit

Në mjediset e Komandës Mbështetëse nisi trajnimi me specialistët e Ndërlidhjes (IT) që punojnë në strukturat e kësaj komande. Qëllimi i këtij trajnimi është aftësimi dhe dhënia e njohurive të mjaftueshme, bazuar në kërkesat e certifikimit të administratorëve të rrjeteve kompjuterike, për instalimin dhe aplikimin e procedurave të reja në këto rrjete kompjuterike, të personelit që aktualisht punon në strukturat e Ndërlidhjes dhe Teknologjisë së Informacionit në Komandën Mbështetëse. Në këtë trajnim marrin pjesë rreth 20 specialistë IT-je, të cilët do të trajnohen për mjediset e transmetimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit si dhe instalimeve e konfigurimeve në rrjetet kompjuterike.

Sipas shefit të Ndërlidhjes në Komandën Mbështetëse, nënkolonel Arben Hoxha, prioritet kryesor i këtij trajnimi do të jetë zhvillimi i praktikës në instalimin e rrjeteve kompiuterike për t' iu përgjigjur automatizimit të burimeve të mbrojtjes mbi sistemin e menaxhimit të TOP, Logjistikës, Sistemeve të Trajnimit dhe Gadishmërisë, Infrastrukturës si dhe programit financiar "Alfa Web". Ky trajnim zhvillohet nga një personel i kualifikuar i kryesuar nga Ing. toger Greta Tako.Trajnimi do të zhvillohet në harkun kohor të dhjetë ditëve, ku në përfundim personeli i trajnuar do të pajiset me certifikatën përkatëse.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA)

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore

Vizitë mësimore e Kursit të Lartë të Oficerit në Prefekturën dhe Bashkinë e Qarkut Fier



Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) si institucion i arsimit të lartë ushtarak, krahas shumë fushave studimore dhe veprimtarive që kanë të bëjnë me sigurinë e mbrojtjen, ka si objektiv në programin e saj edhe bashkëpunimin me institucione shtetërore qendrore dhe lokale në kuadrin e njohjes së veprimtarisë së tyre dhe të shkëmbimit të eksperiencës.

Në këtë kuadër, Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) i Akademisë së Forcave të Armatosura, organizoi një vizitë mësimore një ditore në Prefekturën dhe Bashkinë e Qarkut Fier.

Kursi i Lartë të Oficerit, kryesohej nga Dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kolonel Prof.Asoc. Dr Agim Sula, Shefi i Grupit të Operacioneve të përbashkëta/pedagog përgjegjës për KLO, Kolonele Irela Nebiaj, si dhe pedagogët e Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse, në zbatim të detyrimeve të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 107/2016 " Për Prefektin e Qarkut", të Ligjit Nr. 8756, "Për Emergjencat Civile", etj.

Në Bashkinë e Qytetit Fier, grupi u prit nga Kryetari i kësaj bashkie, z. Armando Subashi dhe nga Drejtori i Emergjencave Civile pranë kësaj bashkie, z.Arben Dimo. Në prezantimin nga ana e tyre, si dhe në bashkëbisedimin e zhvilluar, kursantët u njohën me organizimin dhe funksionimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Fier, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e bashkisë, si dhe vizionin, arritjet, projektet kryesore të realizuara, e në zbatim e sipër. Në të njëjtën kohë u vlerësua, bashkëpunimi i shkëlqyer që ka Bashkia Fier me FARSH, në rastet e emergjencave dhe fatkeqësive natyrore.

Pas vizitës në Bashkinë e qytetit, grupi vizitoi gjithashtu edhe Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier. Në këtë takim, ata u pritën nga Prefekti i këtij Qarku, z.Baki Bala. Në prezantimin e organizuar nga ana e Prefektit, grupi u njoh me organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, misionin dhe kompetencat në përmbushje të detyrave të Prefektit si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku si edhe për rolin e Institucionit të Prefektit, në drejtim të marrëdhënieve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policisë Vendore, menaxhimin e Emergjencave Civile dhe marrëdhëniet me qytetarin. Takimet e realizuara e përmbushën më së miri qëllimin e vizitës mësimore të Kursit të Lartë të Oficerit, të cilat u reflektuan dhe në diskutimet e përbashkëta dhe pyetjet e bëra nga grupi.

Vizitat u mbyllen me foto të përbashkëta si në Bashki ashtu edhe në Prefekturën e Qarkut Fier.

Kolonele Irela Nebiaj

ZHVILLOHET "ORA E KOMANDANTIT" NË KDS

Gjeneral® Hoxha: Metodologjia e RSM bazohet në modelin e aleatëve



Në mjediset e auditoriumit të MM u zhvillua ora e komandantit të KDS. I ftuar për të lektuar këtë radhë ishte Gjeneral Brigade® Bardhyl Hoxha, me detyrë shef i departamentit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në QDK, i cili lektoi temën e draftit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Në këtë aktivitet morën pjesë stafi pedagogjik i AFA, kursantë të KKSHP, KLO, personel i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Qëllimi i prezantimit të gjeneral Hoxhës, ishte angazhimi dhe metodologjia e përdorur për hartimin e draftit të Rishikimit Strategjik i Mbrojtjes (RSM), duke e pështkruar si një proces ciklik kombëtar dhe ndërinstitucional në nivelin strategjik, e shoqëruar me një analizë racionale të interesave dhe objektivave kombëtarë, zhvillimeve të reja në mjedisin e sigurisë, përfitimeve dhe detyrimeve nga sistemi i mbrojtjes kolektive dhe zhvillimit ekonomik e financiar të vendit.

Për rreth një orë, u diskutua rreth rëndësisë së RSM-së, e cila përshkruan interesat strategjike kombëtarë dhe politikat e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë; trajton rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë; evidenton sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që duhet të disponojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), sipas skenarëve më të mundshëm të përdorimit të tyre, nëpërmjet argumentimit analitik të rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, për të bërë të mundur funksionimin si një forcë e mirëpajisur dhe e mirëtrajnuar dhe e aftë profesionalisht, për të realizuar misionin kushtetues.

Për pjesëmarrësit u bë prezent se metodologjia e përdorur në zhvillimin e RSM është bazuar tek modeli i vendeve aleate për planifikimin e mbrojtjes, i orientuar drejt përcaktimit dhe krijimit të kapaciteteve të kërkuara, duke pasur si referenca kryesore Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, e cila jep vlerësimin e rreziqeve të brëndshme dhe të jashtme dhe fuqizimin e sektorit të mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, Programin e Qeverisë për rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH dhe Konceptin Strategjik të NATO-s, si dhe vijon me analizën e rrethanave që ndikojnë në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, gjithashtu ajo përcakton kapacitetet e nevojshme për realizimin e misionit kushtetues dhe detyrave kryesore të FARSH.

Diskutimet ishin tepër interaktive dhe kishin të bënin me atë që RSM është në mbështetje dhe ndërveprim të plotë me dokumentet strategjike dhe bazën aktuale ligjore e normative në fushën e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, me harmonizimin dhe integrimin e kapaciteteve operacionale të FARSH me elementë të tjerë të fuqisë kombëtare, duke rritur ndërvepruesmërinë me forcat e Aleancës. Diskutimet e këtij lloji në orën e Komandantit të KDS janë tepër efektive e frytdhënëese për gjithë kontingjentin kursant të AFA, stafin pedagogjik dhe personelin e KDS, duke e kthyer në një traditë pozitive diskutimet lidhur me zhvillimet aktuale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

6 shkurt 1981-një ditë e paharruar

Përkujtohet 38-Vjetori i rënies së Dëshmorëve të Fekenit

Në kuadër të 38 Vjetorit të Dëshmorëve të rënë në stërvitjen e Fekenit, paraditen e ditës së mërkurë, më 6 shkurt 2019, pranë Obeliskut të garnizonit "Skënderbej", u zhvillua një ceremoni përkujtimore. Në këtë event, ishin të pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, stafi pedagogjik i AFA, kursantë të KKSHP, KLO, si dhe familjarë e të afërm të dëshmorëve.

Në emër të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, në Obeliskun e Dëshmorëve të Fekenit, u vunë kurora me lule nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku dhe Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, u bënë nderime e homazhe nga të afërmit e familjarët e të rënëve, si dhe u mbajt një minutë heshtje, për nder të tyre.

Në fjalën e rastit, Zv/komandanti i AFA, Kolonel Edmond Braneshi, ndër të tjerash vuri në dukje se: "Sot po kujtojmë me respekt këtë ditë të 38 vjetorit të rënies së 11 shokëve tanë në krye të detyrës, të petagogëve tanë të mrekullueshëm, Dushan Shametaj, Çlirim Pulaj e Nikollaq Beros, të bashkëmoshatarëve dhe të shokëve tanë të grupit, Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa, Bujar Ago, të cilët nuk mundën të dilnin të gjallë nga goditja e atij orteku të tmerrshëm. Ne – vioji Kolonel Braneshi, vazhdojmë ti kujtojmë me



respekt dhe mirenjohje, sepse ata sakrifikuan jetën e tyre për të shpëtuar shokët, bënë atë që ne nuk mundëm të bënim për ta, dhe si të tillë gjithmonë do të mbeten në ballin e nderit të Forcave të Armatosura. Dëshmorët e Fekenit, do të mbesin në piedestalin e blertë të Forcave të Armatosura si dëshmitarët e rrugës nga ato vijnë, të vendosmërisë që i karakterizon të dashurisë së përhershme për popullin, shokët dhe tokën e shenjtë". Shefi i Shtabit të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, nga ana e tij, iu drejtua familjarëve të dëshmorëve se bijtë e tyre dhe studentët e atëhershëm të FA, janë dhe do të ngelen yje të frymëzimit për cdo kënd në FA. "Profesioni i ushtarakut, për nga natyra ka vështirësitë dhe sfidat e veta, të cilat kërkojnë përkushtim e angazhime ngandonjëherë dhe sakrifikuese - u shpreh gjeneral Kollçaku. Prandaj, ne përulemi me respekt të thellë ndaj vetmohimit, e jetës së tyre. Ata do të kujtohen brez pas brezi e me respekt për atë vetmohim, si simbol i sakrificës dhe gadishmërisë. Kujtimi i tyre do të mbetet gjithmonë i paharuar- përfundoi gjeneral Kollçaku. Edhe sot, janë të gjalla dhe të paharruara figurat e dashura të: Dushan Shametaj, Nikollaq Bero, Çlirim Pulaj, Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa, Bujar Aga. Ata ranë në fushat e stërvitjes. Ata vinin nga krahina të ndryshme dhe secili kishte nga një histori personale të veçantë. Por ata kishin një qëllim të përbashkët; jetën e kishin vënë në shërbim të gatishmërisë për të mbrojtur Atdheun.

Arsimimi i ushtarakëve tanë jashtë vëndit

Nëntogerët Kamberi dhe Gjergji me rezultate të shkëlqyera në shkollën e Topografisë-Ankara



"Arsimimi i ushtarakëve të rinj është prioriteti ynë.Pas përfundimit të akademisë ushtarake në Turqi një vit më parë, nëntogerët Klodian Kamberi dhe Enri Gjergji arritën rezultate të shkëlqyera edhe në kursin bazë në shkollën e Topografisë në Ankara", shkruan ministrja Xhaçka në Facebook, më 1 shkurt 2019.

Në fund të vitit që kaloi nëntogerë Klodian Kamberi u diplomua si më i miri në Shkollën e Forcës Tokësore në Ankara, mes 1850 studentëve të tjerë. Klodian Kamberi jo thjesht përfundoi një ndër akademitë më të mira botërore, por u diplomua si studenti më i mirë në Shkollën e Forcës Tokësore në Ankara, mes 1850 studentëve. Ndërsa Kamberi vetë ka shkruar se diplomimi si "Oficeri Më i Mirë i Akademisë", e bën të ndihet krenar pasi ka përfaqësuar Shqipërinë në mënyrën më të mirë të mundshme. "Çdo gje që kam arritur deri tani, ja dedikoj familjes sime. Fale mbeshtetjes dhe sakrificave te tyre jam ky qe jam sot. Une sot u diplomova nga Akademia e Forces Tokesore Turke (Turkish Military Academy)", shkruan ai. Gjithashtu Klodian Kamberi ka marrë dhe çmimin "Kadeti i huaj me i mire i vitit" në Turqi.

Akademitë Ushtarake Italiane

Tre të drejta studimi në Itali: Modena, Livorno dhe Pozzuoli

Qendra e Personel Rekrutimit, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ka bërë publike nëpërmjet faqes së web të Ministrisë së Mbrojtjes, kërkesën se do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Italisë për vitin akademik 2019-2020, 3 (tre) të drejta studimi si vijon: Akademinë Ushtarake Modena, 1 (një) kuotë në degën "Karabinieri"; Akademinë Ushtarake Detare, Livorno, 1 (një) kuotë në degën "Xhenio detare"; Akademinë Ushtarake të Forcës Ajrore, Pozzuoli, 1 (një) kuotë në degën "Pilot". Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit ishte dje, më shtatë shkurt 2019.Duhet theksuar se "kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet".Po cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët?



Akademia Ushtarake Modena-Itali



Akademia Ushtarake Detare, Livorno-Itali

Kriteret e pranimit të kandidatëve

Aplikanti që do të aplikojë për të studjuar në një akademive ushtarake në Itali, në radhë të pare duhet të ketë shtetësi shqiptare. Pastaj vijnë kërkesa të tjera: të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 21 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.

Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, mbi 6 (gjashtë), të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak; Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Italisë. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomë dhe certifikatë e maturës shtetërore) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor (KML) i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit. Analizat e gjakut për Hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose Bankat e Gjakut apo Drejtoritë e Shëndetit Publike në rrethet ku banojnë. Formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore dhe formularin e gjendjes gjyqësore, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.



Akademia Ushtarake e Forcës Ajrore, Pozzuoli-Itali

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit

Ja dokumentat që duhen paraqitur ngakandidati i kualifikuar pas përfundimit të testimit:dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor, vrtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi, vërtetim nga përmbarimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

Studentët që do përzgjidhen për të ndjekur studimet në këto akademi, duhet të ndjekin kursin e gjuhës italiane, i cili fillon në muajin mars, pranë Shkollës së Gjuhëve të Huaja të Aviacionit, në Loreto. Nëse studenti nuk ndjek kursin parapërgatitor të gjuhës italiane, duhet ti nënshtrohet testimit të gjuhës (pranë ambasadës italiane), ku duhet të arrijë nivelin 1/1/1/1, sipas STANAG 6001.

Datat e testimit

Për testimin e gjuhës së huaj, aftësive fizike, testi inteligjencës dhe testi psikologjik, aplikantët duhet të paraqiten: testi i gjuhës së Huaj më date 8 shkurt 2019, testi fizik më date 8 shkurt 2019, testi intelektual më datë 11 shkurt2019 dhe testi psikologjik më datë 11 shkurt 2019.

Ekipi i ekspertëve të OKB-së

Testohen kapacitetet e deklaruara të FARSH

Një ekip i OKB ka zhvilluar një vizitë vlerësuese në Forcat e Armatosura të RSH, për kapacitetet e FARSH të cilat janë të deklaruara në sistemin e OKB për ti angazhuar dhe përdorur nëse do të kërkohet në misione nën drejtimin e OKB.

Me anë të një prezantimi në Shtabin e Përgjithshëm, ekipi vlerësues i përbërë nga personel nga OKB dhe Komanda Evropiane e Forcave Amerikane, u njohën me kapacitetet dhe mundësitë e FARSH për të kontribuar ne misione të mundshme te drejtuara nga OKB.

Gjatë vizitës vlerësuese ekipi i OKB me anë të disa mësimeve treguese të zhvilluara nga efektiv të Batalionit Komando dhe Policisë Ushtarake si dhe EOD, iu bë e mundur të njihej nga afër me këto kapacitete të tjera të cilat FARSH është e gatshme ti angazhojë nëse do i kërkohet nga OKB, sikundër FARSH është në fazat e fundit përgatitore për të dërguar dy oficere personel femër në mision paqeruajtës ne Sudanin



e Jugut, nën drejtimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në përfundim të vizitës vlerësuese, e cila është në vazhdën e komunikimeve dhe përpjekjeve të Forcave të Armatosura Shqiptare, për tu angazhuar në misionet e drejtuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, u dakortësua për hapat e mëtejshme që do të ndiqen për ti konkretizuar këto përpjekje.

NATO dokumentar për Kuçovën

Gjenerali Tod Wolters: “Shqipëria vend me rëndësi kritike”

Baza e Kuçovës jo vetëm do të rikthejë lavdinë e dikurshme të atij aeroporti, por do jetë edhe baza e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Kanali televiziv i NATO-s i ka kushtuar një kronikë kësaj baze ajrore, një projekt ky sa ambicioz, aq edhe i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por mbi të gjitha për sigurinë rajonale. Kryeministri Edi Rama, ditën e martë, uroi mirëmëngjes me këtë kronikë të transmetuar nga kanali televiziv i NATO-s.

“Mirëmëngjes dhe me këtë kronikë të mirëseardhur nga kanali televiziv i NATO-s kushtuar Bazës së Kuçovës, ju uroj një ditë të mbarë”, shprehet kryeministri Rama.

Në kronikën e kanalit televiziv të NATO-s thuhet se: “Në Shqipëri gjendet një varrezë aeroplanësh MIG. MIG 15, 17 dhe 19 nuk përdoren më. Aeroplanët i përkasin kohës së regjimit komunist dhe vendndodhja e tyre është baza ajrore e Kuçovës. Në Kuçovë ka pasur gjithnjë e më pak aktivitet me kalimin e viteve. NATO ka rënë dakord të investojë 51 milionë euro për të modernizuar Kuçovën”.

Modernizimi do ta sjellë Kuçovën në standardet e NATO-s

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, shprehet se “modernizimi i bazës ajrore të Kuçovës është shumë i rëndësishëm dhe tregon se Aleanca është ende shumë aktive në të gjithë rajonin tonë”.

“Kjo tregon gjithashtu se Shqipëria është një anëtar i besueshëm i NATO-s. E gatshme të marrë përsipër më shumë



përgjegjësi në të mirë të paqes dhe sigurisë në të gjithë rajonin”, nënvizon Meta.

Sipas tij, modernizimi do ta sjellë Kuçovën në standardet e NATO-s.“Modernizimi përshin riparimin e pistës, të asfaltit dhe të depos, si dhe i shton rajonit një bazë ajrore të NATO-s”, shton Meta.Ndërsa Gjenerali Tod Walters, Komandant në Komandën Ajrore të Forcave Aleate shprehet se “afërsia me rajonin lidhet me të gjithë kontinentin europian. Kur i hedh një sy rajonit të Adriatikut kur shikon krahun jugor të kontinentit europian paqja dhe prosperiteti është i rëndësishëm”.“Për këtë arsye, Shqipëria në rajon, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor bëhet një vend me rëndësi kritike. Shqipëria hyri në NATO në 2009-ën. Ajo ka kontribuar për shumëfishimin e misioneve të NATO-s përfshi Bosnje-Hercegovinën, Kosovën dhe kanë dhënë një mbështetje të vendosur”, theksoi Walters.

Ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaçka, shprehet se “sot, rreth 10% e forcave tona të armatosura është dislokuar në operacione dhe ne do të na pëlqente të mendonim se ne nuk jemi thjesht konsumatorë të sigurisë, por jemi edhe eksportues të sigurisë”.Sipas saj, përtëritja e Kuçovës përfaqëson vazhdimin e bashkëpunimit Shqipëri-NATO.

Ndihemi fat që jemi këtu dhe të jemi pjesë e NATO-s

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama thekson se “të qenit pjesë e NATO-si jep një vendi një burim të ri energjie për të ecur përpara dhe kjo është absolutisht ajo që na bën të ndihemi me kaq fat të jemi këtu dhe të jemi pjesë e kësaj organizate”.

Miklail Naum shprehu kënaqur me përmbajtjen dhe dinamikën e bashkëpunimit në mbrojtje, me besimin se ajo do të intensifikohet në periudhën e ardhshme përmes shumë aktiviteteve në nivel bilateral dhe rajonal. Ai shprehu kënaqësinë e tij me pjesëmarrjen e avionit grek në bazë misionit të Policimit Air dhe përsëriti gatishmërinë e Republikës së Greqisë për vazhdimin e mbështetjes në fushën e arsimit ushtarak dhe shkëmbimit të përvojave në procesin e integrimit evropian.

Mikhail Naum dhe Andrej Lakić, Shef i Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Ministrinë e Mbrojtjes, nënshkruan një plan dypalësh ushtarak bashkëpunimi për vitin 2019, e cila do të zhvillohet kryesisht në fushën e edukimit ushtarak, trajnimin e personelit detare, si dhe bashkëpunimin e forcave speciale dhe të ajrit.

DERI NË VITIN 2028

Ndërtesë të re për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm

Rikonstruksioni i planifikuar dhe i plotë i dy prej pesë pesë ndërtesave ekzistuese në kazermën "Marko Popovic Miljanov" dhe projekti për ndërtesën e re të Ushtrisë së Malit të Zi, e cila do të fillojë punimet tokësore me prioritet në vitin 2019, duke transformuar kështu kazermat në qendrën e ardhshme të forcave malazeze të sigurisë".

Ky është përfundimi i takimit të zhvilluar midis ministrit të Mbrojtjes, z Predrag Boskovic me Drejtorin e Punëve Publike, Dr. Resad Nuhodžić dhe përfaqësues të Agjencisë për planifikimin dhe projektimin në Nikshiq. Në këtë takim ishin edhe shefi i ushtrisë malazeze, gjeneral brigade Dragutin Dakiq dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët kanë vizituar ambientet e kazermës.

Për fazën e parë të projektit, Qeveria ka planifikuar një buxhet kapital prej 1.5 milionë euro, tha ministri Boshkoviq në Masline, pranë kazermës në Andrijevica, një nga prioritetet për Ushtrinë e Malit të Zi.



Ai shprehu kënaqësinë me rezultatin e takimit, duke kujtuar se rindërtimi i objekteve ekzistuese nga batalioni logjistik, kompania e Policisë Ushtarake do tu krijojë trupave dhe rojeve të nderit kushte më të mira pune.

"Vitin e ardhshëm ne do të ndërtojmë një ndërtesë të re për nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Malit të Zi. Pas kësaj, ne do të ndërtojmë një ndërtesë të re për Ministrinë e Mbrojtjes. Siç përcaktohet nga Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Mbrojtjes, deri në vitin 2028, kjo zonë do të përcaktohet plotësisht si zonë ushtarake", tha ministri Boshkoviç.

Drejtori i Punëve Publike, Dr. Resad Nuhodžić tha se për Administratën e Punëve Publike të Maslinës, projekti është prioritar në realizimin e investimeve kapitale në këtë vit. "Menaxhimi i Punëve Publike njeh dhe e kupton rëndësinë e zbatimit të një projekti të tillë për mbrojtjen, Ministrinë dhe ushtria e Malit të Zi, kështu që ne do të marrim të gjitha masat për të siguruar dhe realizuar në afatet e përcaktuara këtë investim", tha Nuhodžić.

Në të ardhmen forcat e sigurisë do të jenë të vendosura në ndërtesën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabin e Pëgjithshëm. Do të jetë edhe spitali ushtarak, i cili do të shërbejë kryesisht për nevojat e qytetarëve të Podgoricës, por edhe për gjithë qytetarët e Malit të Zi, por do të edhe Muzeu i Luftës, etj.

Lockheed Martin-NASA

SR-72 pasuesi i avionit më të shpejtë në botë

Avioni SR-71 Blackbird i kompanisë Lockheed Martin, ishte me rreze të gjatë zbulimi i cili është operuar nga Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Inxhinieria amerikane e hapësirës Clarence "Kelly" Johnson ishte përgjegjëse për shumë nga konceptet novatore të dizajnit. Gjatë misioneve të zbulimit ajror, SR-71 ka operuar me shpejtësi dhe lartësi të larta. Forma e SR-71 ishte e bazuar në A-12, e cila ishte një nga avionët e parë që duhej të projektohej me një seksion kryq të reduktuar të radarëve. Që nga viti 1976, ajo ka mbajtur rekordin botëror për avionin me shpejtësi më të shpejtë të frymëmarrjes ajrore, një rekord i mbajtur më parë nga Lockheed YF-12.

Edhe pse u hoq nga qarkullimi për shkak të kostos së lartë të mirëmbajtjes, vazhdon të jetë avioni më i shpejtë në botë, pasi ka fluturuar tri herë më shpejt se shpejtësia e zërit.

Madje, ditën e fundit në shërbim, pilotët bënë disa fluturime të fundit në të cilat vendosën katër rekorde të reja për sa i përket shpejtësisë.

Por kompania amerikane nuk do të ndalojë me aq. Ata kanë njoftuar se janë duke punuar për SR-72, avionin e radhës supersonik që mendohet se do të arrijë Mach 6 ose gjashtë herë më shpejt se zëri.

SR-71 u prezantua që në vitin 1966 si avion kundërzbulimi, pjesë e luftës së ftohë. Kur lëshohej një predhë kundër tij, avionit i mjaftonte të fluturonte më shpjet se predha për t'iu shmangur.

Avioni SR-71 Blackbird i kompanisë Lockheed Martin ka shërbyer nga vitet 1964 deri në vitet 1998, dhe u prodhuan 32 copë gjithsejt, 12 humbën në aksidente, por asnjëri në dorë të armikut. Gjatë fluturimit të tij të fundit,



më 6 mars 1990, Lt. Kolonel Ed Yielding dhe Lt. Col. Joseph Vida vendosën një rekord shpejtësi duke fluturuar nga Los Anxhelos në Uashington, në 1 orë, 4 minuta dhe 20 sekonda, mesatarisht 3,418 kilometra (2,124 milje) në orë. Në përfundim të fluturimit, ata u ulën në Aeroportin Ndërkombëtar të Washington-Dulles dhe e kthyen aeroplan në Smithsonian.

Në vitin 2014, NASA lidhi një kontratë me Lockheed Martin, për të studjuar ndërtimin e SR-72. Studimet çuan në përfundimin se avionic i ri mund të kapë më shumë se Mak 6, pra me shpejtësi gjashtë herë më shpejt se zëri.

Në vitin 2017, Lockheed Martin tha se avioni SR-72 do të paraqitej për publikun në vitet e para 2020. Ekspertët pretendojnë se sipas parashikimeve të zyrtarëve të Lockheed Martin, ai do të ketë kapacitete të mbërrij në çdo cep të botës për më pak se një orë.

SHBA

Publikohet raporti për mbrojtjen nga raketat

Departamenti amerikan i Mbrojtjes publikoi një raport vlerësimi të mbrojtjes nga raketat, ku ShBA-ja rishikon për herë të parë që pas vitit 2010 politikën e vet të mbrojtjes raketore. Raporti prej 108 faqesh është shkruar nga Agjencia e Mbrojtjes Raketore e Departamentit të Mbrojtjes të ShBA-së. Ai përshkruan kërcënimet e tanishme nga raketat me të cilat përballen Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj, gjendjen e tanishme të kapaciteteve të saj të mbrojtjes nga raketat dhe drejtimin e ardhshëm të studimit dhe zhvillimit të teknologjisë.

Raporti rekomandon të bëhen hulumtime për të përmirësuar sistemet ekzistuese të mbrojtjes me bazë tokësore dhe mundësinë e përdorimit të raketave interceptuese me rreze të shkurtër për të shkatërruar raketat ndërkontinentale, zhvillimin e teknologjisë për përdorimin e dronave me lazer dhe të avionëve luftarakë F-35 për të ndjekur dhe shkatërruar raketat kruiz; si edhe vlerësimin e mundësisë për vendosjen e zbuluesve dhe interceptorëve të raketave në hapësirë.



PËRPARA SHPIKJES SË RADARIT

Ja si gjurmoheshin avionët në fillim të shekullit XX-të

NGA JACOPO PRISCO

Para shpikjes së radarit gjatë Luftës së Dytë Botërore, avionët luftarakë zbuloheshin duke dëgjuar zhurmat e tyre me ndihmën e "gjurmuesve zanorë", që dukeshin më shumë si instrumente muzikore sesa pajisje luftarake.

Këta pararendës të radarëve, që fituan pseudonimet "tubat e luftës" dhe "trumpetat e zërit", u përdorën për herë të parë gjatë Luftës së Parë Botërore nga Franca dhe Britania, për të gjurmuaar avionët gjermanë, Zepelin.

Pajisjet mekanike, ishin në në thelb brirë të mëdhenj të lidhur me një stetoskop. "Kishte nisur zhvillimi i artilerisë që orientohet nga zhurmat"- shpjegon Fil Xhadkins, historian i luftës, dhe pedagog në Universitetin e Lidsit në Britaninë e Madhe.

"Ishte vërejtur prej kohësh, që ishte e mundur të gjendej vendndodhja e një arme nëse 2,3, ose 4 njerëz të ndryshëm që dëgjojnë të shtënë e njëri-tjetrit, marrin shënim kordinatat". Matjet e drejtimit midis dy pikave, do të jepnin vendndodhjen e armës. I njëti proces, u zbatua më pas për të gjurmuar avionët".

Një konfigurim i përbashkët i pajisjes kishte 3 brirë të vendosur vertikalisht plus, një tjetër shtesë në pjesën anësore. Ato që ndodheshin të pozicionuara në qendër, përdoreshin për të gjetur drejtimin e avionit, ndërsa dy të tjerët për të vlerësuar lartësinë e tij. Operatorët do të dëgjonin me anë të stetoskopit, dhe do të përgjonin brirët, derisa të kapnin tingullin më të zhurmshëm. "Kjo do t'ju jepte drejtimin, dhe me pak llogaritje trigonometrike do të gjenin edhe lartësinë e avionit" -thotë Xhadkins. Gjurmuesit e tingujve u përdorën pranë vijës së parë të frontit, për të orientuar armët anti-ajrore, por diapazoni i tyre ishte i kufizuar vetëm në disa milje.

"Numri i herëve që goditej një avion armik, duke përdorur këto pajisje ishte shumë i vogël, ose të paktën ky është numri i rasteve të regjistruara që ne dimë. Por numri i avionëve armiq që rrëzoheshin, ishte edhe më i vogël"- thotë Xhadkins. Për të arritur një rendiment më të mirë, britanikët eksperimentuan ndërkohë me një gjurmuesit statik të vendndodhjes së zërit, të



prodhuar prej betony, dhe me formën e një pjate apo një muri të lakuar, të njohur si "pasqyra akustike".

Këto pajisje, u provuan fillimisht në brigjet jugore dhe lindore të Anglisë gjatë Luftës së Parë Botërore. Më pas pas u ndërtuan në një duzinë vendesh gjatë viteve 1920- 1930. Ato kishin një diametër deri në 9 metra, por një mur në Kent, 96 km në juglindje të Londrës, zgjatej deri në 61 metra.

Shumë vende të tjera, përfshirë Gjermaninë, Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara po zhvillonin gjithashtu gjurmues tingujsh në të njëjtën priudhë. "Zbuluesit e zërit prej betoni, ishin dukshëm të palëvizshëm, por ata kishin rreze më të madhe, rreth 16-24 km, të cilat i jepnin mundësi një personi në Jorkshajër të dëgjonte një Zepelin që afrohet me një shpejtësi prej 96 km/h, dhe të paralajmëronte banorët 15 minuta para mbërritjes së tij mbi qytet"-tha Xhadkins. Pas vitit 1930, u përdorën mikrofona për të kapur dhe përforcuar zhurmën, dhe më vonë, në vitin 1939, sistemet më të përparuara e transformuan zhurmën në një simbol vizual në një ekran ne formë tubi me rreze katodike – një risi që erdhi nga shpikësi i tingullit stereofonik, Alan Blumlein.

"Ato arritën që të gjurmonin deri në rreth 32 km në kushte të mira të motit, Por ajo që e kapërceu edhe këtë teknologji ishte rritja e shpejtësisë së avionëve, që në fund të viteve 1930 udhëtonin ndërmjet 304-384 km/h"- tha Xhadkins. Avionët po bëheshin shumë të shpejtë për zbuluesit e zhurmave, por me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore në vitin 1939, futja e radarit filloi t'i bënte gjithsesi të vjetëruara ato pajisje.

Megjithëse disa lajmëtarë të zhurmave, u përdorën herë pas here deri në fund të luftës. Radari kishte një rreze prej 128 km, dhe luajti një rol vendimtar në fitoren e aleatëve në Luftën e Dytë Botërore. Disa nga gjurmuesit e zhurmave të ndërtuara në Angli (dhe një i ndërtuar në ishullin e vogël të Maltës) kanë mbijetuar deri në ditët tona, dhe disa prej tyre i janë nënshtruar madje edhe restaurimit. /CNN/

Burrat që i dolën zot atdheut

Në kuadër të 75 vjetorit të rënies së pesë dëshmorëve të atdheut Karafil Bello, Sami Golemi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj, Hasan Çerepi pranë fshatit Senicë të Delvinës

Kolonel Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi



Ata ishin djem, që koha i kishte burrëruar para kohe, ishin burra që i dolën zot kombit dhe u bashkuan me formacionet luftarake partizane për lirinë e atdheut. Lufta Nacionalçlirimtare e shqiptarëve parë në thellësinë e veprimeve të saj, ishte luftë pa kompromis kundër pushtuesve, luftë politike dhe revolucion çlirimtar. Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, i qëndroi besnik luftës patriotike nga fillimi e deri në çlirim. Fronti antifashist në Shqipëri dokumenton se u krijuan 288 çeta, 96 batalione, 24 brigada, 8 divizione, 3 korparmata, një forcë njerëzore rreth 70 mijë luftëtarë. Ky front ka meritën se më 29 Nëntor 1944 i solli lirinë përfundimisht Shqipërisë së robëruar dhe rimëkëmbi pavarësinë e Atdheut.

Gjatë LANÇ-it, që me të drejtë ky vit quhet viti i 75 vjetorit të çlirimit Shqipëria me luftën e saj hyri në histori. Në këndshikimin e pas treçerek shekulli, kanë ndryshuar rrënjësisht faktorët historikë që vepronin në rrafshin kombëtar. Shqiptarët sipas rrethanave historike para 75 vjetësh kishin detyrën patriotike për të rrëmbyer armët kundër okupatorit të huaj. Fondi i dokumentacionit historik është disa herë më i pasur se në vitet e luftës, që vijnë edhe nga institucione arkivore aleate dhe kundërshtare të saj. Edhe pse ka gati një çerekshekulli që debatet e hapta ndërmjet rrymave të djathta dhe të majta mbi vlerat e LANÇ-it vazhdojnë shkenca historiografike epokën e luftës partizane e ka pikë reference historike që ballafaqon epokat. LANÇ-i kur zhvishet nga tezat e ngjyrimet politike, ngelet pastërtisht një luftë e merituar e shqiptarëve fitimtarë të radhitur në krahun ruso-anglo-amerikan kundër bllokut të agresorëve fashistë gjermano-italo-japonezë.

Është fakt se Qeveria kuislinge e Tiranës, në solidaritet të detyruar me Italinë fashiste, i shpalli luftë pa asnjë motiv më 10 qershor 1940 Anglisë e Francës, më 28 tetor 1940 Greqisë, më 6 prill 1941 Jugosllavisë, më 22 qershor 1941 Bashkimit Sovjetik, më 7 dhjetor 1941, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shqipëria u ndodh kështu pa vullnetin e saj në vorbullën e Luftës së Dytë Botërore, e detyruar nga pushtuesit italianë. Përballë këtyre fakteve forcat patriotike shqiptare, u takoi detyra të luftonin për çlirimin dhe pavarësinë e vendit. Në këtë kuadër në Shqipëri lëvizja nacionalçlirimtare u rrit bindshëm dhe dukshëm. Nëse i referohemi misionarit anglez Rinald Hibbert tek libri "Fitorja e Hidhur", në të cilin shkruhet: "Në vjeshtën e vitit 1942, veprimtaria e guerrilasve ishte bërë e gjallë në popull, në fund të këtij viti kishte rreth 2000 partizanë të organizuar në njësi, plus një numër i madh forcash territoriale ose rezerviste lokale"; më 5 qershor 1940 në Pezë u krijua çeta e parë partizane, ose "krisma e parë e Europës", një çetë jo vetëm e para në Shqipëri por dhe në Ballkan e Evropë. Çetat u shtuan me rritme të shpejta dhe më tej vjen Konferenca e Pezës më 16 shtator 1942, në përgjigje të thirrjes për t'u bashkuar në luftë kundër pushtuesve "Pa dallim feje, krahine apo ideje".

Në trevën e Labërisë çeta "Çerçiz Topulli" ishte ndër çetat e para, e cila ishte formuar në Fushëbardhë më 12.12.1042. Në dhjetor 1942 ishin formuar 24 çeta partizane nga jugu në veri të vendit; ndërsa në qershor 1943 arritën në 288 çeta partizane në gjithë vendin. Më tej u krijuan formacione të mëdha ushtarake duke i bashkuar çetat në batalione, krijimi i një shtabi drejtues në shkallë vendi dhe me degë nëpër zona. Deri më 10 qershor 1943 u formuan 19 batalione, të cilat deri në çlirimin e vendit u rritën deri më 96 batalione, ku mbi bazën e tyre u krijuar 24 Brigada, 8 Divizione e 3 Korparmata, që ishin organizma të mëdha operativo-strategjike, të cilat realizuan kthesënm e madhe për luftën çlirimtare. Krahas tyre përveç forcave të rregullta partizane vepronin çetat territoriale të Vetëmbrojtjes, të cilat kur ishte nevoja mbështesnin në luftime formacionet e rregullta partizane. Forcat antifashiste shqiptare arritën në rreth 70.000 luftëtarë, që bënë që lufta e shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore të njihej edhe nga fuqitë e mëdha të kohës si: Rusia, SHBA dhe Anglia. Toka shqiptare këtej dhe matanë kufirit, gjatë luftës së madhe çlirimtare u mbrujt me gjakun e dëshmorëve që lehtësish gjenden në çdo memorial e lapidar lavdie, por edhe të shkruar e treguar brez pas brezi në "Yje të pashuar", "Kronikë e ditëve të stuhishme", historikët e brigadave sumuese, ditare e kujtime, që janë ditarë gjaku të derdhur nga një popull luftëtar, besnik i idealit të parëve, se trualli arbëror është i shenjtë, se gjithë populli i madh e i vogël janë trashëgimtarët e Mëmëdheut. Trualli arbëror ka nxjerrë nëpër shekuj heronj e dëshmorë që nuk u dhimbsej jeta e as gjaku përpara shënjtërisë së Atdheut e kombit. Këta djem e burra, por edhe gra e vajza trimëresha sakrifikuan rininë në emër të lirisë dhe përjetësia do t'i shoqërojë në të gjitha kohët me refrenin e njohur: "nëna ju kish rritur/për një botë të re/lule more trima/që ratë për atdhe". Flakadani i atdhetarisë në gjithë truallin tonë ka qenë gjithmonë i ndezur dhe prushi i patriotizmit gjithmonë i nxehtë. Nuk ka dëshmi më të madhe e më solide se gjaku për atdhe. Ata ranë që të pestë në një copëz toke arbënore në shkurt-marsin e vitit 1944, atje pranë Senicës historike të nderit dhe lavdisë, të mençurisë dhe punës, të pushkës dhe të diturisë. Ata ishin një grusht burrash të një ideali, djem stërralli siç i thonë në Labëri. Ata ishin produkt i njësiteve e çetave të para antifashiste që "mbinë" anë e mbanë truallit shqiptar me një ideal madhor: "lirinë". Kështu ata u rregjistruan vullnetarisht dhe dolën e mbushën çetat partizane vullnetarisht, sepse "thirrja e gjakut të të parëve" është më e madhja thirrje që përjetonin brezat në veri dhe jug të vendit. Kurrë shqiptari nuk e ndau sofrën dhe shtëpinë me armikun e shkelësin e lirisë, por veç me mikun e miqtë me ata që ofronin dhe ofrojnë e shtrijnë dorën e miqësisë e vëllazërisë. Kështu është provuar shqiptari në luftra e beteja shekujve. E tillë ishte sprova e madhe edhe përgjatë LANÇ-it. Pluhuri i harresës nuk mund të mbulojë dhe as të fshihet nga kujtesa e kombit shqiptar, ajo lavdi që u shkrua me gjakun e dëshmorëve. Prandaj liria i ka rrënjët thellë në gjakun e të rënëve. Për këtë arsye poeti përcakton qartë: "…duhet të ngrenë nga balta e të rivrasin të rënët". Ja pra aq thellë është memoria e kombit shqiptar për të rënët. Gjaku i të rënëve nuk matet as me numra e as me kile, "as me okë e as me kokë". Bijtë e kombit shqiptar, të mëdhenj e të vegjël vaditën me gjak tokën arbërore në mbrojtje të vatrave të tyre. Pesë trima do të përjetësohen në një memorial lavdie në portën e parë të Labërisë, në drejtimin Fushëvërri-Senicë-Qafa e Luvadhit-Skërficë në afërsi të zonës së Senicës.

Pesë dëshmorët do të jenë roje të lirisë, të tokës arbërore, buzë rrugës së re Kardhiq-Delvinë. Ata do të trupëzohen njësh me tokën e gurtë dhe të sertë, shpirtërisht të lidhur besa-besë si një gjerdan në kalanë natyrore, por edhe përjetësisht në memorien e brezave. Aktet e mëdha njerëzore i japin kuptim historisë. Historia e shqiptarëve është histori mbijetese, përpjekje titanike për të ruajtuar dhe zhvilluar identitetin kombëtar, e sakrificave të mëdha për liri dhe mëvetësi, është historia e vërtetë e këtij kombi, është historia e dëshmorëve të tij. Dhe më mirë, më drejtë, më bindshëm se gjithçka flet gjaku i dëshmorëve të kombit shqiptar, flet historia.

Karafil Bello-fushëbardhasi i lindur për komandant



Dëshmorit të Atdheut Karafil Bello me rastin e 75 vjetorit të rënies 1944-2019

Burri i shquar i Fushëbardhës dhe komandanti trim e sypatrembur Karafil Bello ishte lindur më 1902 në Fushëbardhë të Gjirokastrës, në lagjen Lekgjonaj ku banonin fiset Bello, Cama, Zani e Golemi. Babai i Karafilit Vehipi dhe nëna Nazo ishin njerëz të thjeshtë e punëtor. Babai ishte Fushëbardhas, ndërsa nëna nga fisi Muxharaj i fshatit Kalasë. Karafili kishte tre vëllezër dhe motrën Beraten. Kur ishte vetëm 11 vjeç më 1913 pa sytë e tij masakrat çnjerëzore të kapitenit grek Xhavarës mbi bashkëfshatarët e tij; ndërsa një vit më vonë përjetoi luftën epope që u zhvillua në Skërficë nga 120 burrat e Fushëbardhës dhe fshatrave përreth, por edhe në imazhin e tij ngelën dhe tetë dëshmorët e Skërficës, që derdhën gjakun për atdheun. Kënga "Qaj moj Shqipëri, Ulërij e gjorë,/Gratë e Labërisë shkojnë për në Vlorë,/Me djepe ngarkuar me foshnja në dorë..", u ngulit fort si dëshmi tronditëse e viteve 1913-1914. Ai bëri disa klasë fillore mes sakrificash e varfërisë si çdo fëmijë i vatrave labe. Vitet kalonin dhe Karafili u burrërua para kohe. Rregjimi e përndoqi dhe burgosi trimin nga Fushëbardha, për herë të parë në demonstratën antizogiste të 16 gushtit 1932. Karafili e kishte etiketuar jetën e burgut: "Bodrum natë e bodrum ditë, na plasi kandilja sytë". Por kryengritja në burgun e Gjirokastrës dhe arratisja nga burgu i "7 dritareve" duke lidhur çarçafët ishin spektakolare. Kryengritja dështoi dhe pati 170 të dënuar nga të cilët 8 të vrarë e të plagosur. Në gjyq dënohet me pushkatim, që më vonë ja kthyen dënim me 101 vite burgim. Kur ju mbyllën plagët e mbyllën sërish në hapsanë (birrucë). Karafil Bello u dënua sërish në vitin 1937, në moshën 35 vjeçare dhe meqë ishte shumë hokatar e optimist thoshte: "do të rroj 136 vite. Kur të kemë bërë 101 vite në birrucë do t'i them lamtumirë burgut". Por ditët e lirisë do të zëvendësoheshin nga ditët e zisë së pushtimit të 7 prillit 1939. Karafili hapur deklaronte se: "Pushtimi i Atdheut është si t'i rrëmbesh syrit dritën, dhe kur syrit i vidhet drita, errësira merr në sundim gjithcka". Në dokumentat e luftës për burgun e Gjirokastrës thuhet se: "Karafil Bello dy herë tentoi të këpuste zinxhirët, por kishte dështuar. Midis qindra të dënuar si antirregjim i Mbretit del emëri Karafil Bello. Ishte koha kur Duçja deklaronte se: "Milionat bajonetave të mia do zënë dritën e diellit". Spiunët italianë ju vunë pas trimit fushëbardhas Karafil Bello dhe e arrestojnë sërish në qafë të pazarit. Përsëri në burg dhe nga Gjirokastra e çojnë në Vlorë dhe më tej e internojnë në ishullin "Ventotene" me përmasa 3000 metra me 800 metra dhe në ishullin "Santo Stefano". Këtu ishin dy fushëbardhas Kalem Golemi dhe Karafil Bello. Gjenerali Ernesto Kiminelo dhe koloneli Murgio i ishin vënë pas për ta kthyer në shërbim të tyre "kokëshkëmbin" e Fushëbardhës, por trimi u arratis nga burgu. Karafili gjatë arratisjes u plagos rëndë në kockën e gjurit të këmbës së majtë, ndërsa bashkëmoshatarin e tij Zeman Xhuvanin e vranë rojet e burgut. Karafili u gjend rrufeshëm në Fushëbardhë, në çetën "Çerçiz Topulli". Shpejt do të bëhej komandant i batalionit territorial të Krahinës së Kardhiqit, komandant i batalionit të rinisë si dhe komandant i garnizonit partizan të Cepos. Me ardhjen e Karafilit në çetë, ajo u rrit nga 60 në 80 partizanë në ditën që çeta mori emrin e patriotit të madh "Çerçiz Topulli". Karafili u takua edhe me luftëtarin e lirisë dhe vrasësin e bimbashit, Bajram Ligun-Prongjia bashkë me komisarin Gani Aloçi. Në muajt në vijim Karafili me shokët e tij, Dilaver Poçi, Adil Çarçani, Shefqet Peçi, Gani Aloçi, Riza Veipi etj, ishte sa në Çepunë, në Humelicë, Palokastër, Plesat, Mashkullorë dhe në Zhulat e Fushëbardhë. Karafil Bello ngeli organizatori kryesor i LANÇ-it në krahinë dhe pjesëmarrës në të gjitha luftimet në Cepo, Gjirokastër, Përmet, Murzinë, Delvinë, Sarandë, Rrëzomë e fshatrat e tjerë përrreth. Ai luftonte në këmbë dhe në këmbë u vra për të ngelur përjetësisht në vendin e nderit me titullin dëshmor i Atdheut. Shkëlqeu me aktivitetin e tij luftarak; ndërsa në Çukën e Kuqe, pranë Senicës u shndrua në legjendë trimërie e qëndrese. E mori plumbin në ballë në fillim të shkurtit 1944. Pas vrasjes së tij edhe kali u gjunjëzua dhe u bë rrafsh me tokën. Dajot e Karafilit e morën trupin e tij dhe e përcollën me nderimet më të larta në fshatin Kalasë. Batalioni partizan që komandonte Karafili kur shkoi dhe u inkuadrua në Grupin e Parë u emërtua: "Batalioni partizan "Karafil Bello", që mbeti një frymëzim lirie e trimërie. Shkolla e Fushëbardhës mban emrin shkolla "Karafil Bello" dhe ka qenë menduar që përpara shkollës të vendosej dhe një bust i Karafilit, edhe pse ende i parealizuar Megjithëse kujtimi i heroit Karafil Bello nuk vdes kurrë. Karafili kishte gjithashtu tre vëllezër partizanë Bastriun, Lufton, Çerçizin dhe motrën e tyre Beratja që ishte aktiviste dhe mbështetëse e luftës. Karafil Vehip Bello është nderuar me meritë me dekoratat "Medalja e çlirimit", "Medalja e trimërisë", "Urdhëri i trimërisë", "Medalja e kujtimit" etj., si dhe është shpallur "dëshmor i Atdheut" me Vendim Nr. 65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Gjirokastër.

Sami Golemi – Me pushkë në dorë për lirinë e Atdheut (15.7.1907-14 .3.1944)



Dëshmorit të Atdheut Sami Golemi, me rastin e 75 vjetorit të rënies: mars 1944-mars 2019

Sami Sejdi Golemi, ishte lindur më 15 korrik 1907 në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Rridhte nga një familje me ndjenja e kontribute patriotike e atdhetare si dhe

me emër të nderuar në Fushëbardhë dhe në krahinën e Kardhiqit. Jeta e detyroi që të përballej herët me vështirësitë në fushë e në mal duke e kapërcyer Qafën e Skërficës ditën e natën në borë e suferinë. Përfundoi shkollën fillore, por vuajtjet dhe hallet e kohës e mësuan të dallonte të mirën nga e keqja, padrejtësinë nga e drejta dhe kjo shpesh e revoltonte djalin e ri fushëbardhiot. Familja e tij ishte një familje e madhe. Babai i tij Sejdiu dhe nëna Nefize kishin tetë djem dhe dy vajza. Fisi i tij Golemi ishin njerëz punëtorë, të thjeshtë, të dashur e të respektueshëm në fshat e krahinë, kishin shumë miq në krahinat e Kardhiqit dhe Rrëzomës por edhe deri në Përmet, Korçë, Ersekë, Himarë, Delvinë, Vlorë e Mallakastër. Ishin njerëz zemërbardhë e mikpritës siç i thonë në Labëri, familje bukëdhënë, që rrezatonin mirësi. Familja përjetoi siç thotë populli "të zezat e ullirit" veçanërisht në përballjen me andartët grekë më 1913-1914. Viti '14 shënon edhe dramën e ndarjes forcërisht nga gjiri i familjes së trungut të shtëpisë, babait të tij Sejdiut, i cili u dërgua në ishullin e Korfuzit me dragaminë me gjithë gjënë e gjallë. Por familja mbijetoi. Vëllai i madh i Samiut, Kasëm Golemi mbajti vëllezërinë të bashkuar si dhe në Luftën e Vlorës në 1920 ishte luftëtar me çetën e Fushëbardhës e Zhulatit dhe që kishte luftuar bashkë me Selam Musa Salarinë. Ai ka qenë anëtar i Këshillit Krahinor të krahinës së Kardhiqit deri në çlirimin e vendit. Samiu i doli zot vetes në Fushëbardhë, u burrërua para kohe dhe pas shkollës punuar në bujqësi, por më shumë në blektori, në traditën e Sinanaliajve/Goleme. Në periudhën 15.7.1927 deri 15.7.1929, kreu shërbimin ushtarak në Ushtrinë Kombëtare, në rregjimentin e Gjirokastrës, sikurse dhe bashkëmoshatarët e tij. Kjo ishte periudha "e pjekjes së djelmoshave" dhe që ishte detyrë ndaj shtetit sipas Ligjiit ushtarak "Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare", një ushtri me 700 oficerë, 800 nënoficerë, 7800 ushtarë, që harxhonte deri në 50 % të buxhetit të shtetit, por që nuk ishte e gatshme ta mbronte realisht vendin. Pas ushtrie Samiu më i rritur dhe i pjekur gjykonte thellë problemet e kohës mbante pranë vetes dhe i mësonte nipçet e tij si Feron, Fejzon etj,, me ta kalonte në fushat e në malet e Fushëbardhës, të Çajupit, të Malit të Gjerë, të Delvinës e deri në Bureto. Duke parë shtypjen dhe shfrytëzimin, e urreu regjimin shtypës dhe barbar të Italisë fashiste që erdhi më 7 prill 1939. Më 12 dhjetor 1942 formohet çeta "Çerçiz Topulli" në Fushëbardhë ku, që me themelimin e saj ishte dhe Sami Golemi me bashkëmoshatarë të tij të tjerë. Ai përjetonte një rizgjim të ri të burrërisë shqiptare, kur komandant çete u caktua Dilaver Poçi, komisar Siri Çarçani, zv/ komisar Gani Haloçi dhe itendent Mitat Kondi. Çeta "Çerçiz Topulli" e formuar në Fushëbardhë ishte një ndër 288 çetat, që u krijuan gjatë LANÇ-it në të gjithë vendin. Çeta kishte në ditën e parë 27 partizanë që më vonë shkoi 40 partizanë, numër që erdhi gjithmonë në rritje. Sipas planit çeta kaloi fillimisht në Vurg të Delvinës ku u prit me dashuri nga populli. Më pas çeta kaloi në Dermish ku shkatërroi Urën e Çakallos e më pas në Theollogo për asgjësimin e postave kufitare të armikut në Zminec, në Vërvë e Leshnicë. Materialet e postave kufitare të armikut u morën nga çeta partizane. Çeta kaloi gjithashtu edhe në fshatin Kulluricë, ku hapi depot e drithit dhe u'a shpërndau fshatarëve të varfër, që bëri bujë të madhe për kohën. Në vitin 1943 çeta luftoi me italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Vasjar të Tepelenës, më 11 dhe 12 qershor 1943, luftoi në Urën e Kardhiqit, në Humelicë dhe Cepo. Në 10 deri më 12 gusht 1943 çeta ku bënte pjesë Sami Golemi luftoi me milicët italianë. Në 30 dhe 31 gusht 1943 luftoi me garnizonin italian në Libohovë. Në shtator të vitit 1943 batalioni tek ura e Kardhiqit hyn në Gërhot pas kapitullimit të Italisë fashiste. Sami Golemi mori pjesë aktive në të gjitha veprimet luftarake në përbërje të formacioneve të çetave dhe batalionit territoriale dhe të rinisë. Një pjesë nga katër çetat e batalionit kaloi në batalionin territorial me komandant batalioni trimin Karafil Bello. Sami Golemi në batalionin territorial ishte skuadër komandant dhe



me të njëjtën detyrë edhe në batalionin e rinisë. Në luftimet e Senicës së Rrëzomës tek Kodra e Kuqe, pranë qafës së Ujkut, bie heroikisht komandanti i batalionit territorial Karafil Bello në fillim të shkurtit 1944. Batalioni u riorganizua përsëri dhe në mes të marsit 1944 kalon në luftime në Senicë, Vergo, Kalasë me gjermanët si dhe bashkëpuntorët e tyre. Pararoja bie në përpjekje dhe në këtë luftë vritet Sami Golemi, Sefer Meta, Skënder Pepiu dhe Hasan Çerepi.

Ai ra, për të mos vdekur kurrë në luftën për çlirimin e Senicës, një fshat ngjitur me fashatin e tij të lindjes. Samiu ra duke lënë jetime vajzën një vjeçare Gurien, pa e njohur vajzën e tij dhe ngeli dëshmor i atdheut në përjetësinë e nderit të kombit. As vajza nuk e njohu dot babanë e saj, por njohu bashkëluftëtarët shokët e tij të armëve, njohu kujtimin dhe nderimin për përkushtimin heroik të babait dëshmor ndaj lirisë së Atdheut, respektin e brezave për këtë luftëtar të lirisë e kanë shoqëruar bijën e tij gjatë jetës. Sami Golemi është shpallur "dëshmor i Atdheut" me Vendim Nr. 65 datë 2.10.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Gjirokastër.

Sefer Meta – bir i Golemit kreshnik-dy dëshmorë në një derë



Dëshmorit të Atdheut Sefer Meta rastin e 75 vjetorit të rënies në mars 1944-mars 2019

Ai ishte i lidhur "kokë e këmbë" me luftën. E gjithë familja e tij ishte pjesë e luftës. Frymëzues për të rrembyer pushkën e për të dalë malit ishte i vëllai i tij Dervish Ramo Meta edhe ky dëshmor i atdheut. Sefer Meta lindi në një familje patriotike e atdhetare me tradita më 22 mars 1916 në Golem të Kurveleshit. Prindërit e tij, babai Ramo dhe nënë Pashua ishin njerëz të thjeshtë. Babai i tij Ramo Meta kishte qenë luftëtar i çetave antiandarte greke në vitet 1913-1914; ndërsa i vëllai i tij i madh kishte luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve italianë në Vlorën e flamurit më 1920. Sefer Meta kishte kryer arsimimin fillor në Golem dhe më vonë kishte qenë blektor që në moshë të vogël. Më vonë kishte shërbyer përsëri blektor me agallarët e qytetit të Delvinës, edhe pse gjithë jetën e tij e kaloi në një varfëri të madhe si gjithë vatrat labe në këtë periudhë. Me vullnetin e tij krahas bazave që kish mësuar të shkruante e të lexonte që në shkollë provoi që të lexonte me pasion dhe me vullnet gjuhën shqipe. Në Delvinë krahas punëve të rënda që bënte edhe keqtrajtohej nga agai, që e përdorte si pronën e vet në punët më të rënda edhe pse ishte një fëmijë. Shtypja nuk mundi ta duronte më Sefer Meta, i burrëruar para kohe dhe kështu që me sugjerimin e të vëllait Dervishit lë kërrabën tek shtrunga e agait të Delvinës dhe rrëmbeu pushkën dhe rreshtua me forcat partizane për lirinë e atdheut. Ai u inkuadrua në radhët e Grupit të Parë të Kurveleshit që përfshihej në Zonën e Parë Operative dhe më vonë inkuadrohet në radhët e BrVIS "Heroinë e Popullit". Më vonë transferohet në BrXI-IS me detyrën e mitralierit. Në dimrin e vitit 1943-1944 Brigada merr urdhër që të çlironte Rrëzomën e Delvinën. Djalëria e tij u kthye në burrëri dhe djaloshi ishte bërë tashmë shpatullgjerë dhe mund t'i besoheshin aksione të rëndësishme. Në të gjitha luftimet e brigadës nuk e lëshoi mitralozin nga dora. Në mesmarsin e vitit 1944 një pjesë e brigadës ndodhej e rrethuar nga forcat gjermane e bashkëpuntorët e tyre. Seferi kishte marrë për detyrë të bënte mbulimin me zjarr të tërheqjes së shokëve, por papritur një plumb e plagos për vdekje. Në ndihmë të tij shkuan partizanë të tjerë por ai mbylli sytë përfundimisht në duart e shokëve dhe aktualisht eshtrat e tij prehen në varrezat e Dëshmorëve të Gjirokastrës. Ai është shpallur "dëshmor i Atdheut" me Vendim Nr. 65 datë 2.10.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Gjirokastër. Sefer Meta nuk mundi ta shikonte agimin e lirisë, as vëllai i tij që ra për atdhe dëshmor, por ideali i tyre u trashëgua në breza si ndjenjë e fuqisë dhe mbijetesës popullore, që historia e pushtimeve, poshtërimeve dhe rreziku i fashistizimit të mos përsëritet.

Djali nga Progonati : "Besën për lirinë, gjakun për Atdheun"



Dëshmorit të Atdheut Skënder Pepiaj (Pepiu) 1925–14.3.1944, me rastin e 75 vjetorit të rënies

Nuk është e rastit që në oshëtimën 75 vjeçare të rënies së tij, djalit nga Progonati do t'i risjellim për lexuesin një thënie të tij të preferuar: "Besën për lirinë, gjakun për Atdheun". Skënder Mato Pepiaj (Pepiu) përkujtohet e do të përkujtohet gjithmonë. Ai lindi në prillin e vitit 1925 në Progonat të Kurveleshit. Fëmininë e tij e kaloi në fshatin e lindjes dhe po në fshat mësoi edhe të shkruajë e të lexojë, mësoi këngët e bukura të Labërisë. Familja ku u lind Skënderi ishte patriotike e atdhetare e njohur në mbarë krahinën. Vitet kaluan si dhe prilli i zi i 39-tës e gjeti djaloshin progonatas në radhën e parë të antifashistëve. Pushtuesit arrestuan dhe persekutuan kundërshtarë ndaj fashizmit. Djaloshi 17 vjeçar si shumë djem e burra të tjerë antifashistë dergohet në ishullin e Sazanit, në grykën e Xhenemit. Ishte i njëjti vend ku italianët e 20-tës dërguan atje rreth 1500 patriotë shqiptarë. Por rrethanat u krijuan dhe shpejt u arratis nga burgu-ishull dhe u gjend i lirë në lartësitë labe atje ku çetat e lirisë dhe batalionet kishin ndezur flakë vendin në luftën e madhe antifashiste. Skënderi i ri dhe energjik hodhi shtat në luftime. Fillimisht si korier dhe më tej në zonan e parë operative me qendër në Kuç, në batalione e brigade partizane emri i tij u bë i njohur. I ra kryq e tërthor Labërisë, mori pjesë në dhjetra e dhjetra luftime. Progonati, Lekdushi, Golemi, Kaparieli, Zhulati, Fushëbardha, Tatzati, Kalasa, Fushëvëria, etj., u bënë streha e tij përgjatë luftës. U njoh me shokë e miq dhe la emër të mirë, emrin e luftëtarit sypatrembur në beteja. Partizanët që e njohën Skënderin treguan brez pas brezi trimëritë e tij në LANÇ. Nga "Yjet e pashuar", kësaj serie të mirënjohur shkëputëm disa pasazhe: "Një ditë marsi të vitit 1944, në mëngjes herët forcat partizane kishin zënë kodrat përmbi Senicë. Partizanët kishin disa orë që prisnin shenjën për sulm kundër gjermanëve por dhe bashkëpuntorëve të tyre që ishin tok. Urdhëri ishte të merreshin kodrat dhe gërxhet pastaj do të sulmohej dhe çlirohej qyteti i Delvinës. Skënderi që ishte rritur në beteja kishte me vete një mortajë të vogël si dhe pushkën e tij, që nga dita e parë kur doli partizan. Pushkët filluan të "villnin" zjarr. Skënderi qëllonte me mortajën e vogël, por kur ju mbaruan predhat e mortajës filloi të qëllonte me pushkë, por në betejë e sipër plagoset në kofshën e majtë. Shokët kërkonin ta mënjanonin nga luftimet për plagën e rëndë që kishte marrë por ai me kokëfortësi qëndronte dhe luftonte. Do të luftoj deri në fishekun e fundit, ishte betuar. Lufta ishte e gjatë atë ditë deri në mbrëmje, ndërkohë që 14 partizanë ranë në rrethim së bashku dhe me Skënderin. Me shpejtësi krijuan grupin e mbështetjes së luftimit për dalje nga rrethimi në të cilin bënin pjesë tre partizanë përfshi dhe Skënderin. Rrethimi u ça me sukses, partizanët e tjerë shpëtuan por Skënderin e humbën atë ditë marsi të vitit 1944, duke ngelur përjetësisht në piedestalin e dëshmorëve të kombit, në piedestalin e nderit dhe krenarisë kombëtare. Në xhepin e tij pas vrasjes i gjetën një letër që e kishte shkruar në interrnim, kur ishte në ishullin e Sazanit, por që nuk kishte mundur ta dërgonte: "Të dashur prindër! Jam shumë mirë. Ne do të fitojmë, sepse s'mbyllet zemra në kafaz. Prandaj mos u habitni si dola nga burgu (kafazi) i Sazanit. Ju përqafoj me mall. Biri juaj Skënderi". Skënder Mato Pepiaj (Pepiu) është shpallur "dëshmor i Atdheut" me Vendim Nr. 44 datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Tepelenë.

Për Zhulatin dhe Labërinë të lirë nga çizmja e pushtimit

Dëshmorit të Atdheut Hasan Salih Çerepi 1927-14.3.1944 me rastin e 75 vjetorit të rënies

Hasan Çerepi lindi në një familje me tradita me rrenjë të Zhulatit historik në vitin 1927. Traditat familjare dhe luftarake të fshatit Zhulat janë të mëdha. Fshatrat Fushëbardhë e Zhulat punonin bashkë, luftonin bashkë, dhe e mbronin vatrat e tyre bashkë. Arsimi fillor që mori Hasani nuk ishte i mjaftueshëm, por të tilla ishin rrethanat e kohës. Ai kishte lindur në një fshat me tradita të thella luftarake që të parët e tij të fisit Çerepi dhe të fiseve të tjera kishin luftuar në 1847 në luftën antitanzimat, në luftën kundër osmanëve me Zenel Gjolekën në Mal të Zi, në Manastir, Janinë, në Lëkurës, Delvinë, lufta antiandarte, e deri në LANÇ-in, ku gjaku u derdh lumë për mëmëdhenë. Pushtimin fashist të 7 prillit 1939, si i gjithë fshatrat e Labërisë edhe Hasani e priti me urrejtje dhe kundërshtim të hapur. Në Zhulat, Fushëbardhë dhe gjithë krahinën, lajmi i pushtimit u përhap si rrufeja. Në këtë luftë u përfshi mbarë botën e qytetëruar, dhe nga fitorja e saj varet ekzistenca e kombit, prandaj përbashkimi i forcave mendore, shpirtërore e fizike, ishte në nderin e çdo shqiptari. Prandaj Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar për çlirim kombëtar dhe lirinë ishte dhe ngeli sa heroike aq edhe e rëndësisë së veçantë. Hasani djali i Zhulatit, që doli partizan që 16 vjeç, duke qenë ndër djemtë më aktivë të njësitit të fshatit Zhulat si dhe më gjerë të krahinës së Kardhiqit. U lidh me lëvizjen nacionalçlirimtare sikundër edhe shokët e tij, Hamit Pula, Axhem Çela, Qemal Shabani, Hasan Çela etj., që janë sot dëshmorë të Zhulatit, Labërisë dhe të të gjithë Shqipërisë. Ai u betua se: "armën e hodha supit për



Zhulatin tim dhe për Labërinë që të rrojë e lirë nga çizmja e pushtimit fashist". Me idealin e lirisë luftoi trimërisht në të gjithë betejat për çlirim në jug të vendit, në Cepo dhe te Ura e Kardhiqit, në Gjirokastër e në Libohovë, në Lunxhëri dhe në zonën e krahinës së Rrëzomës e Delvinës. Por kur forcat partizane luftonin për marrjen e lartësive pranë fshatit Senicë të Delvinës në përleshje me forcat gjermane dhe bashkëpuntorët e tyre ra në krye të detyrës në një ndër sulmet për marrjen e fshatit Senicë duke ngelur përjetësisht në këngët, në kujtimet e popullit, në memorialët e lirisë dhe çlirimit të atdheut. Hasani ishte pjesë e armatës së luftëtarëve për çlirim, pjesë vitale e LANÇ-it, ku tashmë është katërcipërisht e vërtetuar dhe e gjithëpranuar se: "Partizanët dhe Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare i siguroi çlirimin dhe pavarësinë e vendit". Gjaku i Hasan Çerepit dhe bijëve dhe bijave të tjerë të Shqipërisë i sollën vendit lirinë dhe e integruan atë mes kombeve më të civilizuara dhe më dinjitoz të Europës dhe botës. Dëshmori Hasan Çerepi nuk ka pasur fotografi, por mjeshtri piktor Kosta Raka duke mësuar në detaje jetën e tij përmes një analize të detajuar të fotografisë së babait të Hasanit, realizoi mjeshtërisht skicë-foton e dëshmorit me tipare origjinale të fytyrës së të atit në 75 vjetorin e rënies së tij. Gjaku i djaloshit zhulatas vadit ende pemën e lirisë së kombit tonë. Ai tashmë ka hyrë në memorien e fshatit, krahinës, Labërisë dhe kombit shqiptar. Hasan Çerepi është "dëshmor i Atdheut" me Vendim Nr. 65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit Gjirokastër, shkolla e Zhulatit mban emrin e tij dhe eshtrat prehen në varrezat e dëshmorëve.



6 SHKURT 1981 - NJË DITË E PAHARRUAR

38-Vjetori i rënies së Dëshmorëve të Fekenit

Pranë "Obeliskut" të ngritur në garnizonin "Skënderbej", u kujtua më 6 shkurt, 38 Vjetori i Dëshmorëve të rënë në stërvitjen e Fekenit, kur më 6 shkurt 1981 ranë heroikisht në krye të detyrës 11 ushtarakë të mrekullueshëm: Dushan Shametaj, Çlirim Pulaj, Nikollaq Bero, Bilbil Pashaj, Aleko Gjoni, Qemal Lika, Besnik Shehu, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopadhe Bujar Ago, të cilët nuk mundën të dilnin të gjallë nga goditja e atij orteku të tmerrshëm. Ishin të pranishëm Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof.Asoc. Bajram Begaj, stafi pedagogjik i AFA, kursantë të KKSHP, KLO, si dhe familjarë e të afërm të dëshmorëve. Shefi i Shtabit të FA, Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, iu drejtua familjarëve të dëshmorëve se bijtë e tyre dhe studentët e atëhershëm të FA, janë dhe do të ngelen yje të frymëzimit për cdo kënd në FA. "Profesioni i ushtarakut, për nga natyra ka vështirësitë dhe sfidat e veta, të cilat kërkojnë përkushtim e angazhime ngandonjëherë dhe sakrifikuese. Prandaj, ne përulemi me respekt të thellë ndaj vetmohimit, e jetës së tyre. Ata do të kujtohen brez pas brezi e me respekt për atë vetmohim, si simbol i sakrificës dhe gadishmërisë".





